

AKT-THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME "TREGU AGROUSHQIMOR I SHITJES ME SHUMICE DHE PAKICE", SH.A KUKES

Ne Tirane, sot me date 02.04.2008, u hartua Akti i themelimit per krijimin e Shoqerise "Tregu agroushqimor i shitjes me shumice dhe pakice", Kukes me aksioner te vetem Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes si perfaqesues i prones shtetore, perfaqesuar nga Z.Genc Ruli Minister.

Neni 1.

Themelues i shoqerise eshte Ministrine e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes ne baze te ligjit nr 7638 date 19.11 1992 "Per shoqerite tregtare".

Neni 2

Emertimi i Shoqerise eshte "Tregu agroushqimor i shitjes me shumice dhe pakice", Kukes e cila do te jete e shenuar ne vulene e saj dhe do te paraqitet ne cdo dokument qe leshohet, firmose dhe vulozet.

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne adrese: Llogja e re Kukes, Shqiperi. Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj dhe te hape filialet e veta ne te gjitha teritorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 4

Personalitetin e saj ligjor shoqeria e fiton nepermjet depozitimit te akteve te themelimit prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Shoqeria ka nje kohëzgjatje te veprimtarise se saj te papercaktuar.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise ka vleren 2,000,000 (dy milion) leke te ndare ne 2,000 aksione me vlere nominale 1,000 leke sejcili. Kontributi eshte shlyer plotesisht nga aksioneri.

Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- Funksionimi i tregut agroushqimor te shitjes me shumice dhe pakice.
- Dhenia me qira e hapesirave dhe ambienteve te tregut me shumice dhe pakice personave fizike dhe juridike qe tregtojne prodhime agroushqimore.

16

- Dhenia me qira e hapesirave dhe ambienteve personave fizike dhe juridike qe sigurojne sherbime te ndryshme per perdoruesit e tregut me shumice dhe me pakice, me qellim qe aktiviteti i tyre tregtar te jete sa me eficient.
- Nxitja e shitjes se prodhimeve agroushqimore lokale, duke organizuar aktivitetet perkatese si panaire, ekspozita, si dhe promovimi i prodhimeve lokale gjate gjithë vitit.
- Shoqeria siguron transparence per transaksionet tregtare qe zhvillohen brenda tregut me shumice. Ajo grumbullon dhe shperndan te dhena per tregun tek te gjitha palet e interesuara. Shoqeria bashkepunon ngushte me te gjitha inspektoret perkates dhe autoritetet ekzekutive publike per te siguruar qe:
 - transaksionet qe zhvillohen ne tregun me shumice te behen ne perputhje me ligjin,
 - perdoruesit e tregut te kene licensen qe kerkon ligji
 - prodhimet qe tregtohen ne treg te plotesojne te gjitha kerkesat sipas ligjit.
- Shoqeria rregullon funksionimin e tregut me shumice nepermjet nxjerrjes te Rregullores se Brendeshme dhe nese eshte e nevojshme bashkepunon me autoritetet publike perkatese.

Neni 7

Organet Drejtuese

- ♦ Veprimtaria e shoqerise kryhet nepermjet organeve drejtuese te saja qe jane:
 - Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve
 - Keshilli Mbiqezyres
 - Drejtoria
- ♦ Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

Keshilli Mbiqezyres perbehet nga:

- g. Mimoza Asekiu
- h. Brunhilda Stamo
- i. Julinda Bare
- j. Bilbil Keraj
- k. Anita Hameli
- l. Avni Tota

Ekspert i pare kontabel i shoqerise do te jete: Zj. Ingegerta Bebi

Drejtor i shoqerise do te jete Z. Gazurr Dajani

17

Neni 8

Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumenteve te saj themeluese.

Firmosur me daten 02.04.2008

MINISTER
GENC RULI

18